

SPECIFIKIME TEKNIKE TE PROJEKTIT

KINEMA MULTIFUNKSIONALE/TRY GJIROKASTRA


Bashkia Gjirokaster

Shtator 2022

HARTOI: Ark: J. MUHO

Ing: A. PESHA

Ark: N. SEJDO

Handwritten signatures in blue ink, including a large signature for J. MUHO and a smaller signature for N. SEJDO.

SPECIFIKIME TEKNIKE

KINEMA MULTIFUNKSIONALE

Paraqitje

Ky specifikim teknik është hartuar enkas për projektin “KINEMA MULTIFUNKSIONALE”. **GJIROKASTER**”.

Zerat e rradhitur në këtë specifikim, përkohë me zerat e preventivuar, mbështetur në projektin e hartuar, në **“Manualet teknike të çmimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”**, të miratuar nga K.M. i Republikës së Shqipërisë, me vendim të korrikut 2015 dhe në analizat e hartuara për zerat për të cilët manuali nuk ka vlerësim.

Permbajtja

Kërkesa të përgjithshme.

1. Punë ekzistuese
2. Zbritja dhe ngarkimi i materialeve në lartësi.
3. Kontrolli i pluhurave.
4. Punime të paparashikuara.
5. Pastrimi i thellë i kështjës.
6. Punë e kryer jo-mirë.
7. Skelëritë.

SEKSION 1 Punime prishje

- 1.1 Hëqja e dyerve
- 1.2 Prishja e veshjeve me pllaka dhe shtresa
- 1.3 Prishja e shtresave ekzistuese.
- 1.4 Transport materiale ndërtimi.

SEKSION 2 Punime ndërtimi

- 2.1 Hidroizolim me një shtresë mapei dhe dyshemese.
- 2.2 Suvatim i brendshëm
- 2.3 Dysheme dhe mure veshje me pllaka
- 2.4 Lyerja me bojë hidromat në punime rehabilitimi dhe të reja
- 2.5 Dyert të brendshme
- 2.6 Ambientet Sanitare
- 2.7 Lavamanet
- 2.8 Furnizimi me ujë (tubat dhe rakorderite)
- 2.9 Pilete dyshemeje
- 2.10 Tubat e shkarkimit

SEKSION 3 Punime elektrike

- 3.1 Specifikime elektrike të veçanta
- 3.2 Llampat fluoreshente
- 3.3 Çelesat e ndriçimit
- 3.4 Prizat
- 3.5 Kutitë e çelesave automate
- 3.6 Siguresat (automatet)

SEKSION 4 Punime H/Izolimi

4.1 Prishja e shtreses hidroizoluesete tarraces

4.2 Hidroizolimi i Tarraces

SEKSION 5 Restaurimi i Fasadave

Kerkesa te pergjithshme.

1. Pune ekzistuese.

Perpara fillimit te punimeve Kontraktuesi duhet te inspektoje dhe verifikoje te gjitha njesite ekzistuese te cilat do te mbahen ose riperdoren. Te gjitha materialet ekzistuese qe mbeten prone e Investitorit do te mbrohen duke perdorur mbulesa te perkohshme. Nuk duhet te mbingarkohen dhe te rezikohen elementet struktorore te godines.

Duhet te kihet kujdes gjate zhvillimit te punimeve brenda salles te filmit. Te miren masa per mbrojtjen e paisjeve te salles dhe mureve akustike ekzistues levizshmeria e puntorise brenda kantierit te jete e kujdesshme.

2. Zbritja dhe ngarkimi i materialeve ne lartesi.

Kur materialet ose mbeturinat zbriten nga lartesi, duhet te kihet kujdes per te parandaluar renien ne menyre te tille qe te mos krijohet rrezik per demtimin e personelit dhe te elementeve ekzistues te godines ne te cilat nuk kryhen nderhyrje.

Transporti i materialeve te punes nga Kontraktori brenda kantierit duhet te jete i siguruar ne menyre qe mos shkatohet demtime ose derdhje gjate zhvendosjes ne vendin e punes. Te gjitha materialet qe sillen nga Kontraktori duhet te stivohen dhe te magazinohen ne menyre te pshatshme per ti mbrojtur nga demtimet, thyerjet rreshkitjet etj.

3. Kontrolli i pluhurave.

Te meren masa per te kontrolluar perhapjen e pluhurit dhe krijimin e nje zone te papershtatshme perreth. Gjate prishjes se siperfaqeve te suvase duhet te vendosen perde pluhuri per te mbrojtur ato zona ende ne funksion te objektit. Te lagen me uje siperfaqet qe germohen per te parandaluar perhapjen e pluhurit.

4. Punime te paparashikuara.

Sipermarsi duhet ti paraqese Investitor/Supervizor per aprovim volume e plota te punimeve te paparshikuara qe kerkon te kryej. Te gjitha llogaritjet, viztimet per keto pune do te konsultohen/miratoohen me Supervizorin perpara se te fillojne.

5. Pastrimi perfundimtar i kantierit.

Ne perfundim te punimeve kontraktori duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impiantet dhe inertet ndertimore, materialet qe kane teperuar, mbeturinat, skelerite dhe ndertimet e perkohshme te cdo lloji dhe te lere shehsin e lire dhe veprat te pastra dhe ne kushte te pranueshme.

SPECIFIKIME TEKNIKE

KINEMA MULTIFUNKSIONALE

6. Pune e kryer jo-mire.

Cdo pune qe nuk perputhet me specifikimet e punes nuk do te meret parasysh. Sipermaresi do te korrigoj te gjitha defektet me shpenzimet e tij. Ne rast se Kontraktori gjate punimeve te rikonstruksionit gjykon te adaptoje punime ne funksion te ketij procesi cdo ndryshim do te behet me miratimin e Supervizor/Investitor.

7. Skelerite

Çdo skeleri e kerkuar duhet skicuar ne pershtatje me KTZ dhe STASH. Nje skelator kompetent dhe me eksperience, duhet te marre persiper ngritjen e skelerive qe duhet te çdo tipi. Kontraktori duhet te siguroje, qe te gjitha rregullimet e nevojshme, qe i jane kerkuar skelatorit te sigurojne stabilitetin gjate kryerjes se punes. Kujdes duhet treguar qe ngarkesa e coperave te mbledhura mbi nje skeleri, te mos kaloje ngarkesen per te cilen ato jane projektuar. Duhet marre te gjitha masat e nevojshme qe te parandalohet renia e materialeve nga platforma e skeles. Skelerite duhen te jene gjate kohes se perdorimit te pershtatshme per qellimin per te cilin do perdoren dhe duhet te jene konform te gjitha kushteve teknike.

1. Punime prishje

Metoda e prishjes

Puna per prishje do te filloje vetem pasi te jene stakuar energjia elektrike dhe rrjete te tjera te instalimeve ekzistuese te objektit.

Metodat e prishjes se pjesshme, duhet te jene te tilla qe pjesa e struktures qe ka mbetur te siguroje qendrueshmerine e nderteses dhe te pjeseve qe mbeten.

Siguria ne pune

Kontraktori duhet te sigurohet se vendi dhe pajisjet jane :

a) Te nje tipi dhe standarti te pershtatshem duke iu referuar vendit dhe llojit te punes qe do te kryhet

b) Te siguruar nga nje teknik kompetent dhe me ekperience

b) Te ruajtura ne kushte te mira pune gjate perdorimit

Gjate punes prishese te gjithe punetoret duhet te vishen me veshje te pershtatshme mbrojtese ose mjete mbrojtese si: helmata, syze, mbrojtese, mbrojtese veshesh, dhe bombola frymemarrijeje.

1.1 Heqja e dyerve.

Hegje dyersh dhe dritaresh, duke perfshire kasen, telajot, etj. Heqja e tyre nga vendi do te behet manualisht, duke çmontuar menteshat qe i mbajne dritart/dyert te lidhura ne murature. Do behet cmontimi duke ruajtur pa demtuar pjesen e paturave te muratures.

Sistemimin e materialit qe ekziston brenda ambientit te kantierit dhe grumbullimin ne njelloj vend te caktuar ne kantier per riperdorim.

SPECIFIKIME TEKNIKE

KINEMA MULTIFUNKSIONALE

Çmontimi i nje dritare/dere eshte perlllogaritur te realizohet ne nje kohe jo me te gjate se 1 ore.

1.2 Prishja e veshjeve me pllaka dhe shtresa

Hapesira e tualeteve eshte veshur me pllaka. Kjo veshje do te hiqet duke u kujdesur qe goditjet te mos shkojne deri ne siperfaqen e muratures per te mos e demtuar materialin e tulates.

Nje pjese e muratures ne tualet eshte e veshur me pllaka qe arrijne lartesi nga 230 cm nga dyshemeja. Kjo veshje do te hiqet duke perdorur dalte e çekiç dhe duke u kujdesur qe goditjet te mos shkojne deri ne siperfaqen e muratures per te mos e demtuar materialin e tulates.

Per pllakat e sheshit/murit prishja perfshin prishjen e llaçit qe ndodhet poshte, pastrim, larje, duke perfshire largimin e materialeve jashte ambientit te kantierit, si dhe çdo detyrim tjeter.

Eshte perlllogaritur qe nje m² siperfaqe e veshur me pllake betoni/mermeri te zhvishet nga nje punetor per jo me shume se 1 ore.

1.3 Prishja e suvase ekzistuese.

Prishja e suvase ne siperfaqet e mureve do te behet deri ne daljen e siperfaqes se muatures. Gjate germimit do te punohet ne menyre te tille qe struktura e murit te mos demtohet nga goditjet. Ne punimet e rikonstruksionit, do te goditet me cukitje e gjithë siperfaqja e suvase, per pjeset te cilat dalin te demtuara kane lageshti apo shtresat e poshtme te suvase jane shkeputur nga siperfaqja e murit do te prishen plotesisht.

1.4 Transport materiale ndertimi.

Pervec sa eshte pershkruar me siper, i gjithë materiali i mbetur (mbeturinat) do te hidhen nga Sipermarresi ne zona te siguruara prej tij dhe te miratuara nga Supervizori i objektit. Çdo material i planifikuar per te mbetur prone e ndermarresit ose do te grumbullohet ne grumbuj te paster ose do te ngrakohet dhe do te transportohet tek zonat e planifikuara per ruajtje.

2.Punime ndertimi

2.1 Hidroizolim me nje shtrese mapei e dyshemese.

Ky process do te aplikohet ne dyshemene e tualeteve per te mos lejuar depertimin e lageshtise ne ambientet e tjera dhe ne mure vertikale ne lartesine 30 cm.Shtresa e hidroizolimit do te aplikohet pas shtreses niveluese.

2.2 Suvatim i brendshem

Sprucim i mureve dhe tavaneve me llaç çimentoje te lenget, per permiresimin e ngjitjes se suvase dhe rforcimin e siperfaqeve te muratures, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per ta perfunduar plotesisht sprucimin. Suvatim i realizuar nga nje shtrese me trashesi 2 cm llaçi bastard m-25 me permbajtje per m²: rere e lare 0,005 m³; llaç gelqereje m-1: 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; uje, i aplikuar me paravendosje te drejtuesve ne mure (shirtit me llaç me trashesi 15 cm çdo 1 deri ne 1,5 m), dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per ta perfunduar plotesisht suvatimin.

2.3 Dysheme dhe mure veshje me me pllaka

Veshja e dyshemese

SPECIFIKIME TEKNIKE

KINEMA MULTIFUNKSIONALE

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin.

Për shkolla, kopshte dhe qendra sociale duhet që pllakat të jenë të Klases V, me sipërfaqe të ashpër, në mënyrë që të sigurojnë një ecje të sigurtë pa rreshqitje.

Në ambientet me lageshtirë (WC, banjë dhe dushë) duhet të vendosen pllaka të klases I, që e kanë koeficientin e marrjes së ujit < 3 %.

Bordurat vertikale sipas llojit të shtrimit të dyshemese janë me ngjyrë të errët ose me të njëjten si pllaka që është shtruar dyshemeja, me lartësi 10 cm dhe trashësi 1.5 cm. Bordurat kanë gjatësi sa pllaka dhe do të vendosen në aksin e bashkimit të pllakave.

Veshja e mureve

Është parashikuar në projekt/preventiv që muret e tualeteve në një lartësi deri 2.3 m dhe deri në tavan për hapësirat e tjera të vishen me pllaka, gjithashtu do të hidroizolohen për të evituar probleme të formimit të lageshtisë dhe mykut.

Veshja e mureve me pllaka sipas materialeve ndërtimore të murit dhe sipërfaqes së tij metodat e veshjes së murit mund të ndahen po ashtu dy klasa

- Ngjitja e pllakave me llaç (për sipërfaqe jo të drejta)
- Ngjitja e pllakave me kolle (për sipërfaqe të drejta)

Përsa i takon ngjitjes të pllakave të tipeve të ndryshme me llaç, duhet që **punimet t'u** përmbahen këtyre kushteve.

Baza në të cilën ngjiten pllakat e tipeve të ndryshme, duhet të jetë e pastër nga pluhuri dhe të jetë e qëndrueshme.


Perberja e llaçit është e njëjta siç është e përshkruar më lart. Trashësia e llaçit duhet të jetë jo më pak se 15 mm.

Po ashtu, llaçi duhet t'i plotësojë kriteret e ruajtjes së ngrohjes dhe të rezistencës kundër zërit. Ngjitja e pllakave me kolle, bëhet kur sipërfaqja e bazës mbajtëse është e drejtë. Kolla vendoset sipas nevojës me një trashësi prej 3 mm deri në 15 mm. Të gjitha kriteret e lartpërmendura, të **cilat duhet t'i plotësojë** llaçi, vlejne edhe për kollën. Mbas të thahet llaçi ose kolla, duhet që fugat e planifikuara, të mbushen me një material të posaçëm (bojak). Fugat nëpër qoshe dhe lidhje të mureve duhet të mbushen me ndonjë masë elastike (si psh silikon).

Për secilin sipërfaqe 30 m² të veshur me pllaka të ndryshme, është e nevojshme vendosja e fugave levizëse.

SPECIFIKIME TEKNIKE

KINEMA MULTIFUNKSIONALE



2.4 Lyerja me boje hidromat ne punime rehabilitimi e te reja

Ne rehabilitim procesi i lyerjes se siperfaqeve te mureve dhe tavaneve kalon neper tre faza si me poshte:

1-Pregatitja e siperfaqes qe do te lyhet

Para lyerjes duhet te behet kruajtja e ashper e bojës me makineri (fleks) se meparshme nga siperfaqja e lyer, mbushja e gropave te vogla apo demtimeve te siperfaqes se murit me ane te stukimit me material sintetik dhe berja gati per paralyerje. Perpara fillimit te procesit te lyerjes duhet te behet mbrojtja e siperfaqeve qe nuk do te lyhen (dyer, dritare, etj.) me ane te vendosjes se letrave mbrojtese.

2-Paralyerja e siperfaqes se pastruar.

Ne fillim te procesit te lyerjes, behet paralyerja e siperfaqeve te pastruara mire, me gelqeren te holluar (Astari). Per paralyerjen behet perzierja e 1 kg gelqere me nje liter uje. Me perzierjen e pergatitur behet paralyerja e siperfaqes vetem me nje dore.

Norma e perdorimit eshte 1 liter gelqere e holluar duhet te perdoret per 2 m² siperfaqe.

3-Lyerja me boje hidromat e siperfaqes

Ne fillim behet pergatitja e perzierjes se bojës hidromat te lenget e cila eshte e paketuar ne kuti 5 – 15 litershe. Lengu i bojës hollohet me uje ne masen 20-30 %. Kesaj perzierje i hidhet pigmenti deri sa te merret ngjyra e deshruar dhe e aprovuar nga Supervizori i punimeve dhe pastaj behet lyerja e siperfaqes. Lyerja behet me dy duar.

Norma e perdorimit eshte 1 liter boje hidromat i holluar duhet te perdoret per 2.7 – 3 m² siperfaqe. Kjo norme varet nga ashpersia e siperfaqes dhe lloji i bojës se meparshme.

2.5 Dyert te brendshme

Pasi u vleresua gjendja ekzistuese u pa e arsyeshme zevendesimi i te gjithë dyerve ekzistuese ne hollin ne hyrje dhe ne katin e pare pasi dyert ishin te amortizuara.

Keshtu qe dyert jane propozuar dyer prej druri me mentesha te forta dhe materialet qe do te perdoren te jene te cilesise se larte. Dyert do te kene te njejtin punim dhe elemente si dyert


SPECIFIKIME TEKNIKE

KINEMA MULTIFUNKSIONALE

ekzistuese. Siperfaqja qe do te behet me xham do te mbrohet me elemente hekuri. Mund te perdoren elementet prej hekuri te dyerve ekzistuese.

Vendosja e dyerve dhe plani i hapjes eshte realizuar i tille qe te plotesoje kushtet e daljes se shpejt ne raste emergjencash, sipas standarteve te vendosura nga MASH.

Do vendosen dyert e reja duke iu pershtatur dimensioneve te hapesirave te dyerve ekzistuese. Dimensionet do te merren nga matjet ne vend. Fiksimi i kasese se deres me paturen e murut do te behet me ane te vidave me upe.



2.6 Ambientet Sanitare

Ne bashkepunim me stafin sipas kerkeses se tyre, kemi parashikuar ambiente sanitare qe te jene sa me te pershtatshme. Njyt sanitare jene te veçanta dhe lavamanet te jene te mjaftueshem.

Per te siguruar uje te vazhdueshem dhe te ngrohte ne lavamane, eshte parashikuar instalimi i boliereve si dhe realizimi i rjetit te nevojshem hidraulik. Banjo dhe parabanjo te jene te ajrosura, te ndriçuara dhe te ventiluara.

WC do jene te tipit alla frenga te cilat do te fiksohen ne dysheme ose ne mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndeprere veshjen me pllaka te murit. Para fiksimit te tyre duhet te behet bashkimi me tubat e shkarkimit te ujrave. WC mund te jete me dalje nga poshte trupit te saj ose me dalje anesore ne pjesen e pasme te WC. Ne WC me dalje anesore tubi i daljes duhet te jete ne lartesine 19 cm nga dyshemeja.

WC-ja duhet te siguroje percjellshmeri te larte te ujrave, rezistence ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, rezistence ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjate punes ne to dhe mundesi te thjeshta riparimi.

WC-ja lidhet me tubat e shkarkimit te ujrave me ane te tubit ne forme sifoni. Tubi i lidhjes se WC me tubat e shkarkimit duhet te jete PVC me te njejtat karakteristika teknike te tubave te shkarkimit te ujrave. Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te WC (zakonisht ato jane 100-110 mm).

SPECIFIKIME TEKNIKE

KINEMA MULTIFUNKSIONALE



2.7 Lavamanet

Ne hapësirën e parabanjes janë parashikuar të vendosen dhe lavamanet. Lavamanet janë porcelain. Muri ku do të fiksohen është i veshur me pllaka në lartësinë 2.3 m.

Lavamanet duhet të sigurojnë përcjellshmëri të lartë të ujrave, rezistencë ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, rezistencë ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi.



2.8 Furnizimi me ujë (tubat dhe rakorderite)

Për furnizimin me ujë të ambienteve sanitare do të përdoren tuba PPR (Polipropilen) me diametër 20 – 25 mm, që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078.


Tubat për furnizimin me ujë duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjenteve kimike, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi e transporti, ngjyritje të thjeshtë dhe të shpejta, jetegjatesi mbi 30 vjet dhe rezistencë ndaj ujit të ngrohtë. Tubat e furnizimit me ujë duhet të vendosen në të gjithë lartësinë e ndërtesës, në formën e kollonave, në ato nyje sanitare ku aparatet janë me të grupuara dhe mundësisht sa më afër atyre nyjeve që kërkojnë ujë të pijshëm. Ato instalohen brenda në mur. Në rast se gjatësia e shtrirjes së tyre është e madhe duhet të vendosen kompesatore të tipit me brryll të thjeshtë ose tip omega.

Linjat kryesore horizontale të furnizimit me ujë vendosen me pjerrësi në ngjyritje në drejtim të levizjes së ujit jo më pak se 2 %.

2.9 Piletë dyshemeje

Piletat për shkarkimet e ujrave të dyshemeve dhe duhet të sigurojnë përcjellshmëri të lartë të ujrave, rezistencë ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe bashkimi; sipas standartit UNI EN 1451

- Materiali PE
- Dimensioi DN 40/50
- Thellessia e inkasos 57 mm



Piletat e shkarkimit duhet të vendosen në pjesën më të ulët të sipërfaqes ku do të mbledhen ujratar. Zakonisht ato nuk vendosen në afërsi të bashkimit të dyshemeve me muret, por sa më afër mesit të dyshemesë.

SPECIFIKIME TEKNIKE

KINEMA MULTIFUNKSIONALE

2.10 Tubat e shkarkimit

Per shkarkimet e ujrave brenda ambienteve do te perdoren tuba plastike PVC me gomine. Keto tuba duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti, instalim te thjeshte dhe te shpejte si dhe jetegjatesi mbi 30 vjet.

Lidhja e tubave te dergimit me kollonat e shkarkimit duhet te behet me tridegeshe te pjerreta nen nje kend 45 ose 60 grade

Diametri i tyre do te jete ne funksion te daljeve te pajisjeve sanitare qe jane vendosur.

3.Punime elektrike

Rikonstruksioni perfshin edhe instalimin e ri elektrik.

Eshte parashikuar ndriçimi i ambienteve me ndriçues me fuqi te mjaftueshme per te garantuar nje ndriçim ne perputhje me normat ne fuqi, dhe nje numer te mjaftueshem prizash per secilin ambient, sipas destinacionit te tyre.

3.1. Specifikime elektrike te veçanta

- Operatori ekonomik qe merr pjese ne tender duhet jete e pajisur me licensen profesionale perkatese ne kete fushe dhe duhet ta kete te dokumentuar me dukementat perkatese te leshuar nga organet kopetente.
- Per cdo punim elektrik qe do te kryhet do te vihet ne dijeni sherbimi perkates dhe do te kryhet ne prezence te elektricistit te turnit.
- Zevendesimi i automateve ,siguresave ,prizave,etj te demtuara do te kryhet me materiale te te njejtave parametra teknik.
- Zevendesimi i percjellesave dhe kabujve do te kryhet me parametrat ekzistuese dhe pa devijuar nga projekti ekzistues.

Materjalet dhe aparatet qe duhet te perdoren ne ndertimin e impjantit duhet te kene te gjitha cilesite e fortesise, kohezgjatjes, izolimit dhe te funksionimit te mire; dhe duhet **gjithashtu te jene te tilla qe t'i rezistojne veprimeve mekanike, gerryese, termike dhe lageshtires** per ato qe duhet te jene ne kontakt me te gjate punes. Gjithashtu, jane nen pergjegjesine e sipermarresit montimet dhe çmontimet perkatese te pjeseve te instalimit per realizimin e provave dhe te verifikimeve. Te gjitha aparatet, kuadrot, centralet e inkasuar, çelesat, butonat, prizat etj., duhet te vendosen ne veper nepermjet kutive te instaluara me llaç çimentoje m - 1.2, duke u kujdesur veçanerisht qe instalimi i kutive te mesiperme te behet rrafsh me murin ne lidhje me siperfaqet e suvatuara dhe te veshura, ne menyre qe te mos verifikohen dalje apo futje te teperta te ketyre kutive

Tubi fleksibel duhet te jete i nderfutur ne kutite qe permbajne komandat ose prizat, qe ne asnje menyre te mos demtojne kavot qe hyjne ne kuti. Çelesat, butonat, prizat e spinave duhet te vendosen ne lartesine 1.25 cm nga dyshemeja. Eshte absolutisht i

ndaluar perdorimi i llaçit me allçi ose i lendeve të tjera të ngjashme për vendosjen në veper të kutive, mbylljen e kanaleve të hapura dhe të çdo punimi tjetër në murature të nevojshem për impjantin

3.2 Llambat fluoreshente

Llambat.

Te gjithë ndriçuesit neone duhet të jenë të tipit me katode të nxehte, përjashto zonat ku tensioni nuk sigurohet. Për përdorim të përgjithshëm karakteristikat janë si më poshtë dhe gjithë llambat duhet të kenë produkte të barabarta me ato në tabelle. Gjith llambat duhet të kenë ngjyra të njëjta, duhet të jenë të paketuara në zarfe.

Ndriçuesit neonet dhe pajisjet ndihmëse të jenë si më poshtë .

Tipi 874 EL Comfort 60 °, FL 4x18, difuzor lamelar i erret1, ngjyre e bardhe.
Tipi 791, Attiva 60 °, FLC 1x18L, difuzor lamelar, i erret1, ngjyre e bardhe .

Çdo ndriçues duhet të ketë një bllok konektori të fiksuar për të dalluar qartë kabllot hyrëse të fazes, nulit dhe tokës. Ky bllok konektori duhet të ketë permasa të tilla që brenda tij të përfshihen kabllot me 2.5 mm² në çdo konektor. Faza e çdo neoni duhet të ketë një siguresë të përshtatshme dhe që mund të nderrohet pa probleme.

3.3 Çelesat e ndriçimit

Vendodhja e çelesave të ndriçimit tregohet sipas projektit dhe skicave të bera nga inxhinieri elektrik projektues.

Në përgjithësi çelesat e ndriçimit gjatë gjithë ndertesës duhet të jenë të përshtatshme për montim të rrafshet

Duhet të kenë një shkallë minimale prej 10 amper.

Çelesat sipas vendit ku do të përdoren dhe mënyrës së takimit-stakimit i ndajme:

- Çelesa një polësh
- Çelesa dy polësh
- Çelesa deviat
- Çelesa me llampe sinjalizimi me stakim kohor

Çelesat një polësh përdoren zakonisht në ambiente të vogla ku kemi një numër të vogël (1 ose 2) ndriçuesish.

Çelesat dy polësh përdoren zakonisht në ato ambiente ku kemi një numër të madh ndriçuesish të cilët mund të takohen edhe në mënyrë të pjesshme psh. Neper klasa, ku janë dy rreshta me ndriçues, mund të ndizen të alternuar vetëm njëri rresht ose të dy njëkohësisht.

Çelesat deviat janë të përdorshëm në ato ambiente ku kemi dy hyrje/dalje, pasi ata takojnë ndriçuesit në njërin hyrje/dalje dhe mund të stakojnë në hyrjen/daljen tjetër, ose mund të përdoren neper korridore.

Çelesat me llampe sinjalizimi me stakim kohor janë të përdorshëm neper shkallë, neper korridore etj.

3.4 Prizat

Nje sistem i kompletuar me njesi prizash duhet siguruar sipas projektit dhe skicave te bera nga inxhinieri elektrik projektues.

Te gjitha prizat qe do te montohen duhet te jene te tipit me tokezim dhe me mbrojtje ndaj femijeve.

Prizat ashtu si edhe çelesat mund te jene te tipit qe montohen nen suvatim ose mbi suvatim.

Prizat i ndajme sipas detyres qe do te kryejne ne:

- Priza tensioni njefazore, dy fazore ose trefazore
- Priza telefoni dhe sistemi LAN
- Priza TV

Gjithe prizat, derisa te behet nje tjetër specifikim, duhet te jene te tipit 16 amper 2-pin dhe te dala ne sipërfaqe. Ato duhet te kene montim rafsh duhet te kene nje ngjyre qe te shkoje me paftat e çelesave te ndriçimit.

3.5 Kutite e çelesave automate



Kutite e çelesave automate jane panele elektrike per ambiente te veçanta, njelloj si panelet e kateve, me ndryshimin qe numri i elementeve eshte i reduktuar. Montimi i kutive mbi suvatim behet me ane te vidave me upa, ndersa ato nen suvatim fiksohen **me allçi e suvatim dhe s’duhet te dalin mbi nivelin e suvatimit.**

Ne figuren paraqiten kutite e automateve qe vendosen nen suvatim.


3.6 Siguresat (automatet)



Siguresat (Automatet) jane ndares qarku, te cilat veprojne ne menyre automatike ne raste mbingarkesash dhe e hapin qarkun duke i nderprere tensionin ngarkeses. Per kete ne perzgjedhjen e amperazhit te automateve duhet te merret parasysh ngarkesa qe ai mbron. Automatet qe perdoren ne ambientet publike jane manjetotermik dhe me mbrojtje diferenciale. Automatet jane njesi mbrojtje nga mbingarkesat. Ato vendosen ne kutite e çelesave automate, ne panelet e kateve dhe ne panelin kryesor te TU. Automatet sipas numrit te fazave qe ato mbrojne i ndajme ne: nje fazor dhe ne trefazor. Sipas amperazhit i ndajme: 6 A; 10 A; 16 A; 20 A; 25 A; 32 A Automatet i ndajme sipas numrit te poleve: nje polesh, dy polesh, tre polesh dhe kater polesh.

Tipi MTC 45 - 4500 - C

Ndares tensioni manjetotermik kompakt 1P - 1P+N - 2P - 3P - 4P



Specifikimet teknike

Kapaciteti i nderprerjes: 4,5 kA

- **Karakteristika e takim** - stakimit: C
- **Tensioni nominal:** 230 - 400 V
- **Frekuenca:** 50 - 60 Hz
- **Tensioni I izolimit:** 500 V

Ndares qarku kompakt 3P C10 4.5KA 2M



Ndares qarku diferencial nje – copesh kompakt 4P C25 4.5KA AC/0.


Tipi SD - class AC Ndares qarku diferencial 2P - 4P



Specifikimet teknike

- **Tensioni nominal:** 230 - 400 V
- **Frekuenca:** 50 - 60 Hz
- **Tensioni i izolimit:** 500 V

Tipi SD - class AS (selektive) Ndares qarku diferencial 2P-4P



Specifikimet teknike

- Tensioni nominal: 230 - 400 V
- **Frekuenca:** 50 - 60 Hz
- **Tensioni i izolimit:** 500 V

4. Punime H/Izolimi

4.1 Prishja e shtreses hidroizoluesete tarraces

Hidroizolimi i taraces se godines eshte demtuar prandaj eshte vendosur te hiqet dhe te realizohet hidroizolim i ri. Do te behet prishje e shtreses horizontale te hidro- izolimit te tarraces, e ndertuar nga dy shtresa te mbivendosura leter katramaje, duke perfshire

heqjen e kapakeve te parapetit e te çdo pjese metalike dhe venien menjane e spostimin ne kantier te materialeve qe formohen per tu vendosur perseri.

4.2 Hidroizolimi i Terraces

Hidroizolimi i taraces se godines eshte demtuar prandaj eshte vendosur te realizohet hidroizolim i ri. Projektuesi ka dhene te gjitha detajet per hidroizolimin e taraces/çatise si dhe per menyren e ngjitjes se shtreses hidroizoluse ne parapetin e taraces, si dhe detaje te tjera te domosdoshme per zbatimin e punimeve.

Materialet qe perdoren per ndertimin e shtreses hidroizoluses duhet te jene:

- a) elastike, pasi ato i nenshtrohen shformimit nga ndryshimet e temperatures
- b) i padepertushme nga uji

Per ndertimin e qilimit hidroizolues duhet te zbatohen me rreptesi nje sere kerkesash:

- 1) Siperfaqja e shtreses ku do te ngjitet qilimi hidroizolues duhet te jete e rrafshet.
- 2) Shtresa rrafshuese duhet te jete e thate ne siperfaqe dhe ne thellesi te saj, sepse bitumi nuk ngjitet mbi siperfaqe te lagur. Prova e lageshtis se shtreses rrafshese behet duke hedhur pak zift te nxehte mbi shtrese, po qe se dalin fillucka themi se shtresa ka lageshti.
- 3) Siperfaqja e shtreses rrafshuese duhet te mos permbaje pluhur, sepse bitumi nuk ngjitet mbi siperfaqe me pluhur.
- 4) Fletet e kartonit te bitumuar para se te ngjiten duhet te pastrohen shume mire nga pluhurat me futça te posaçme.
- 5) Fletet e kartonit te bitumuar ngjiten mbi shtresen rrafshuese dhe njekohesisht edhe midis tyre, duke krijuar ndertimin e qilimit hidroizolues.
- 6) Mastika qe perdoret per ngjitjen e kartonit te bitumuar duhet te nxehet dhe te hidhet ne tarrece deri ne temperaturen 170°C-180°C.

Shtresat hidroizoluses.

Ne fillim ngjitet shtresa epare. Ne çdo shtrese fletet duhet te mbulojne njera – tjetren, duke formuar nje tegel me gjeresi 10 cm. Mbase eshte mbaruar shtresa e pare, ngjitet shtresa e dyte, e pastaj e treta e keshtu me radhe, sa shtresa te kete *qilimi hidroizolues*.

Tegelat e mbulimit te fleteve te nje shtrese nuk duhet te bien mbi tegelat e shtreses se meparshme, prandaj fletet e njeres shtrese vendosen te zhvendosura ndaj fleteve te shtreses tjeter.

Mbase ngjitet edhe shtresa e fundit me karton te bitumuar, mbi te hidhet edhe nje dore mastike.

Ne qilimin hidroizolues do te kemi nje dore mastik bitumi me shume se numri i shtresave me karton te bitumuar. Ne kete menyre kur qilimi hidroizolues behet me dy

shtresa, do të kemi tre duar mastike bitumi (dy duar që ngjiten shtresat dhe një dorë që hidhen mbi shtresën e fundit).

Për të mbrojtur qilimin hidroizolues nga vjetrimi dhe për të rritur jetegjatesinë e tij, qilimi hidroizolues duhet të mbrohet nga rrezet e diellit.

Mbrojtja do të bëhet me shtresë llusterimento me trashësi 3-4 cm, Kjo shtresë mbron qilimin hidroizolues nga rrezet e diellit dhe lejon ujë që të rrjedhë lirshëm në të.

Për mbrojtjen e parapeteve është menduar mbulimi me llamarinë zingat në të gjithë sipërfaqen duke përfshirë kallepet në përputhje me të gjitha kerkesat për të siguruar terracen, me një punë me cilësi.

5 Restaurim i Fasadave

Pastrimi i veshjes së fasadave dhe kollonave me pllakë mermeri, me spatulë ose furçë teli

-veshjet të cilat rezultojnë se kanë përqendrim të fortë kalcifikimi të papastertive, do të pastrohen me spatulë ose furçë teli;

-pastrimi do të jetë i kujdesshëm, në konsultim me specialistët e restauratorëve.

-çdo detyrim tjetër për mbarimin e plote të procesit të punës në mënyrë perfekte.

Pastrimi i veshjes së fasadave dhe kollonave me pllakë mermeri, me dorë tretësire 10% alkool me ujë.

-veshjet të cilat rezultojnë se kanë papastërti nga shkrime grafiti, të cilat do të pastrohen me tretësire uji të pastër me 10% alkool, me pambuk;

-pastrimi do të jetë i kujdesshëm, në konsultim me specialistët e restauratorëve;

-çdo detyrim tjetër për mbarimin e plote të procesit të punës në mënyrë perfekte.

Pastrimi i veshjes së fasadave dhe kollonave me pllakë mermeri, me kompresore rere karboni.

-pas përfundimit të ; **1-pastrimeve** me dorë; **2-** zëvendësim i pllakave të demtuara;

3-zëvendësim i demtimve të kornizave dhe davancave; **4-veshje** atje ku pllakat e mermerit mungojnë; do të bëhet pastrimi total me kompresore me rere karboni.

-pastrimi do të bëhet pas provave të mëparshme dhe të përcaktimit të shkallës së ferkimit në konsultim me specialistët e restauratorëve;

-çdo detyrim tjetër për mbarimin e plote të procesit të punës në mënyrë perfekte.

Zëvendësim dhe veshje me pllakë mermeri, sipas materialit ekzistues në përmase ngjyra dhe teknike të vendosjes,

SPECIFIKIME TEKNIKE

KINEMA MULTIFUNKSIONALE

1-Zevendesim i pllakave te demtura pas nje vezhgimi te kujdesshem ne vend te te gjithë siperfaqes; **2-Zevendesim i kornizave te dritareve dhe vetratave, si dhe te davancaleve;**

3-Vendosje e pllakave te mermerit atje ku mungojne nga demtimi ne vite;

-**materiali** i mermerit do te zgjidhet i njejte me ate qe zevendeson ose mungon;

-**furnizuar** dhe vendosur ne veper mbi nje siperfaqen e pergatitur me pare, e ngjitur me llaç, stukim ne fuga me bojake me tonalitet sipas pllakes veshese;

-**pastrim** i plote;

-skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër per mbarimin e veshjes ne menyre perfekte

-**materiali** para se te vendoset duhet te aprovohet nga kontraktori dhe arkitekti;

-**çdo** detyrim tjetër per mbarimin e plote te procesit te punes ne menyre perfekte.

Vendosje e skelerise perimetrale te fasadave se bashku me mbulesen plastike te printuar,

-**per te kryer punimet e restaurimit te fasadave, do te vendosen skelat dhe mbulesa plastike me vrime me printimin e imazhit te objektit.**

SPECIFIKIME TEKNIKE
KINEMA MULTIFUNKSIONALE

HARTOI: Ark: J. MUHO
Ing: A. PESHA
Ark: N.SEJDO